



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1118/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Fejzullah Rexhepi, Rafet Haxhaj, Nenad Lazić, Afijete Sada-Gllogjani, Zyhdi Haziri, Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Shukrije Shala kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), për certifikimin e rezultateve përfundimtare për Kuvend Komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.12.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si i palejuar** apeli i parashtruar nga Shukrije Shala kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), për certifikimin e rezultateve përfundimtare për Kuvend Komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 30.11.2017, nga Shukrije Shala kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, me të cilën ka pretenduar se pas certifikimit të rezultateve nga KQZ, rezulton se është bërë shkelje në Komunën e Klinës në kuotën e përfaqësimit Gjinator, pasi që Kuvendi i kaluar në Komunën e Klinës ka pasur 27 kandidat ku 9 prej tyre kanë qenë femra, ndërsa tani sipas ndarjes së ulëseve Kuvendi Komunal ka 27 anëtar dhe prej tyre 8 janë femra. Me këtë rast parashtruesja e ankesës ka theksuar se asaj i është bërë e padrejtë sepse ju është shkelur e drejta që edhe ajo si femër të ketë një ulëse në Kuvend.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**apeli është i palejuar**

Pretendimet ankimore të apelueses, që janë të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së mbi certifikimin e rezultateve në këtë rast të anëtareve të Kuvendit Komunal, është vendim i pa ankimueshëm, në kuptim të nenit 106 par.3 të LZP-së, në të cilin parashihet se “Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja”. Që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për rezultate përfundimtare mund të ankimohet, por nuk mund të ankimohet vendimi për certifikim të rezultateve siç është rasti i apelit të parashtruar nga Shukrije Shala.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1118/2017 me datën 01.12.2017.

**Kryesues i Panelit**  
Gyltene Sylejmani



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***